



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:303786

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05718944

C.nr.813/23

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren e çështjes Fllanza Hashani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses R A nga Klina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna Klinë-, në Klinë, me objekt kontesti, kompensimi i pagës së 13-të, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses R A nga Klina, ashtu që DETYROHET e paditura, Komuna Klinë-D, në Klinë, që paditëses, R .A në emër të kompensimit të pagave të 13-ta, për vitet 2019, 2020, t'ia paguajë shumën prej 754.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila llogaritet nga data e parashtrimit të padisë (data 27.12.2023) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 124,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

II. REFUZHET e pabazuar pjesa e kërkesës, përtej shumës së miratuar në pikën I. të këtij dispozitivi, gjegjësisht shuma prej 754.00 €, e kërkuar për vitet 2021 dhe 2022.

A r s y e t i m i

Paditësja, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, në këtë gjykatë, me datën 27.12.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna Klinë-D, në Klinë, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, vlera e kontestit 1,000.00 euro. Në padi,

i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në QKMF në Klinë. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, më konkretisht nenin 17 par. 2, e paditura nuk ka bërë kompensimin e pagës së 13-të për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, në lartësi të pagës mujore bazë prej 377,00 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin sipas dispozitave ligjore të lartcekura, i është drejtuar gjykatës me qëllim që të detyrohet e paditura, që palës paditëse t'ia kompensojë pagën e 13-të për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, në shumën e përgjithshme prej 1,508.00 euro. Ka shtuar se, pala e paditur ka deklaruar suficit buxhetor. Si përfundim, pala paditëse me padi ka kërkuar që të detyrohet e paditura që t'i paguaj asaj në emër të së drejtës që ka lindur me dispozitat e KKSSH-së, shumën e kërkuar me padi, përfshirë kamatën dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 20.05.2024, kundërshton padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar në ligj, por edhe të palejuar duke u thirrur në jashtëafatshmërinë e saj. Ka shtuar se paditësja ka dështuar që të respektojë dispozitat nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, dhe afatet që parashihen me këto dispozita, si dhe nuk i ka shterrur mjetet e brendshme. Ka theksuar më tej se KKSSH është në kundërshtim me Ligjin e Punës, konkretisht me nenin 90 par. 2 dhe 5, dhe nenin 99.2 të tij. Në këtë kontekst, KKSSH-në e ka atakuar, duke theksuar se ajo nuk është nxjerr në bazë të ligjit, e as nuk është respektuar ligji lidhur me procedurën për nxjerrjen e saj, gjë që e bënë të pa zbatueshme dhe nuk e detyron të paditurën për ta zbatuar. E paditura, madje nuk ka mjete financiare për zbatim, ka theksuar më tej se e paditura (si punëdhënës) nuk ka lidhur kontratë me ndonjë organizatë sindikale komunale, në mënyrë që të merr përsipër detyrime të tilla (më gjerësisht si në përgjigje në padi).

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi, me datë 29.02.2024. Me aktvendimin për përgjigje në padi gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të nxjerr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë. Gjykata, në kuadër të autorizimeve ligjore, e në kuptim të dispozitave nga neni 398 dhe 399 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi ka vlerësuar me kujdes kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, gjeti së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë. Gjykata i vlerësoi të gjitha kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit, siç parashohin dispozitat nga neni 398, i cili përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare*

seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë ”. Ndërsa, neni 399.1, përcakton: “ *Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.*”

Pala paditëse, në shtojcë të padisë, i ka bashkangjitur edhe kontratën e punës për kohë të pacaktuar, të cilën e ka lidhur ajo me Komunën e Klinës-DKSHMS, si dhe listën e pagës.

Nga kontrata e punës, shihet se pala paditëse, është në marrëdhënie pune në QKMF në Klinë, ndërsa, nga lista e pagave, vërehet paga mujore e palës paditëse.

Nga provat e dorëzuar me padi, vërtetohet fakti se paditësja dhe e paditura kanë lidhë që më parë kontratë të punës në sektorin e shëndetësisë, dhe me hyrjen në fuqi të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKSSH), me datën 12.06.2018, në dispozitën e nenit 17.2, ka paraparë: *Punëdhënësi mund të kompensohet me pagën e trembëdhjetë (13) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*”. Gjykata, në kuptim të dispozitave të cituara nga neni 398 të LPK-së, e në lidhje dispozitën e sipër-referuar të KKSSH-së dhe me dispozitat nga neni 245 par. 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në të cilën përcaktohet se “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*”, gjeti së kërkesëpadia e paditësja është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shuma e miratuar për kompensim fitohet për dy (2) vite punë, në emër të shpërblimit të papaguar të pagës së 13-të. Shuma e miratuar gjegjëse fitohet duke shumëzuar pagën bazë të paditëses me 2 vite pune (2019-2020), apo $377 \text{ €} \times 2 = 754.00 \text{ €}$.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen pjesërisht dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, e datës 12.06.2018, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021. Me nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se “*punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e trembëdhjetë (13), për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, të nxjerrur nga Gjykata Supreme e Kosovës, përcaktohet në mënyrë shprehimore se

çështja e kompensimit të pagës së trembëdhjetë (13), për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditësjat) për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13), krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa, nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Gjykata vlerëson se, në instancë të fundit, ka qenë në barrën e punëdhënësit që të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e një kërkesë të tillë, apo jo.

Andaj, gjykata mbi bazën e gjendjes aktuale, e cila i referohet pasivitetit ekskluziv të palës së paditur (mos-shfrytëzimi i mundësive ligjore, si dhe të provave që e vërtetojnë një gjendje pamundësie, apo likuiditeti), konsideron se, dispozita ligjore e nenit 17 par. 2 e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, e datës 12.06.2018, në rastin konkret, në mënyrë opcionale, është e karakterit detyrues për palët kontraktuese.

Së këndejmi, duke e marrë për bazë edhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme, nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, duke qenë se detyrimin e të provuarit të faktit nëse ka mundësi buxhetore i ka takuar të paditurës, del se kjo e fundit, deri në ditën (datën) e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nuk e ka përmbushur këtë detyrim, gjegjësisht, ka dështuar që gjykatës t'ia bëjë të provuar me provë konkrete, se nuk kanë mundësi buxhetore, për përmbushjen e një detyrimi të tillë që rrjedhë nga KKSSH-së. Pra, ky mendim juridik i gjykatës më të lartë në Republikën e Kosovës, sa i përket bazës juridike të kërkesës, barrën e të provuarit, ia ka lënë të paditurës, sepse gjykata nuk ka, dhe nuk mund të ketë, të dhëna lidhur me mundësitë buxhetore të sektorëve të caktuar të sistemit.

Kësisoj, gjykata duke vlerësuar bazën ligjore të theksuar më lartë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësjat duhet miratuar pjesërisht si e bazuar. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia e paditëses, qartazi përputhen me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në bazën juridike konkrete. Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, pasi ka vlerësuar qëndrimin dhe sjelljen inerte të të paditurës (në kuptim të mundësive ligjore në dispozicion), dhe si rrjedhojë e kësaj, bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, lidhur me dispozitën e nenit 17.2 të KKSSH-së, ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit, ndërsa, sipas dispozitës së nenit 399.1 të LPK-së, ka vendosur si në pikën II. Sa i përket pjesës refuzuese gjykata është bazuar në pushimin e efekteve juridike të KKSSH-së, me datën 10.06.2021, e duke u bazuar në dispozitën nga neni 90.4 të Ligjit të Punës, e cila përcakton: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.*" Kërkesa për vitin 2021 është refuzuar,

sepse për shkak të efektit juridik të KKSSH-së deri në qershor 2021, ajo cilësohet se nuk është arrirë për pagesë, sepse paga e 13-të jepet në rastet kur punëmarrësi ka punuar për vitin e plotë përkatës, dhe pranimi i pagës së 13-të sipas logjikës së ligjit do të pranohej nga gjykata, poqëse do të përmbushej në plotëni ai vit pune. Pra, kërkesa për të tilla raste do të pranohej se është pjekur për njohje, me datën 31.12. të vitit gjegjës. Ndërsa sa i përket kërkesës për vitin 2022, e njëjta nuk gjen nuk gjen mbështetje në KKSSH -në e lartë cituar pasi që Kontrata Kolektive në fjalë nuk prodhon efekt juridik përtej kohës së vlefshmërisë së saj.

Në përgjithësi, gjykata ka vlerësuar pretendimet e palëve, përkatësisht, në veçanti, përgjigjen në padi, të dhënë nga pala e paditur, për të cilën konsideron se ajo ka dështuar që të shpreh qëndrimin dhe kundërshtimin e saj në tërësi lidhur me mundësitë ligjore, por ka dhënë pretendime dhe kundërshtime jolëndore, jopërmbytësore dhe retorike (jo adekuate). Njëra nga çështjet për të cilat është dashur gjithsesi që të jetë reagimi i të paditurës në përgjigje në padi, është ajo, e shprehur dhe ngritur nga paditësja në referatin e padisë, me pretendimin se: “ *e paditura ka deklaruar suficit buxhetor*”.

Sa i përket pretendimit për jashtëafatshmërinë e kërkesës, duke e ndërlidhur këtë pretendim me mosezaurimin e mjeteve të brendshme nga pala paditëse tek e paditura, me një kërkesë, pastaj, edhe për të shfrytëzuar mjetin juridik të brendshëm, vlerësoi si të pabazuar, sepse për të tilla kërkesa nuk ka nevojë për kërkesa para punëdhënësit, për arsye se ato janë kërkesa monetare, të natyrës detyrimore, për të cilat pala ka të drejtë që në mënyrë të drejtpërdrejtë të parashtojë padi në gjykatë.

Lidhur me kamatën, për vonesën e krijuar me mospërmbushjen e detyrimit nga e paditura, ndaj palës paditëse, gjykata është bazuar në dispozitat ligjore të par.1 dhe 2 të nenit 382 të LMD-së, kur si datë të fillimit të rrjedhjes së kamatës ka pranuar datën e ushtrimit të padisë në gjykatë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 452.1 lidhur me 449 të LPK-së, të cilat përfshijnë shpenzimet specifike, si: për parashtrim të padisë, shumën 104 €, për taksë gjyqësore shumën prej 20 €, gjithsejtë për shpenzime procedurale është pranuar shuma prej 124,00 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata, në pajtim me nenin 398 dhe 399 të LPK-së lidhur me nenin 17.2 të KKSSH-së, dhe 90.4 të Ligjit të Punës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:303786
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05718944

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGANË KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL

C.nr.813/23, data 22.05.2024

Gjyqtarja
Fllanza Hashani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.